

Kthim pergjigje nr. 181 Tue 6/23/2020 2:12 PM

Pershendetje Zj. Vladi!

Në përgjigje të kërkesës tuaj dërguar elektronikisht ne Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, në kuadër të Ligjit 119/2014 datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit”, regjistruar me nr. 181, në regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve, e cila ishte në përputhje me nenin 11 të ligjit të sipërcituar, ju sqarojmë si më poshtë vijon:

Ju jeni pajisur me Çertifikatë Rezidence për vitin 2019 në zbatim të dispozitave të Marrëveshjes për eliminimin e taksimit të dyfishtë, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Italisë.

Individi që pajiset me Çertifikatë Rezidence në zbatim të nenit 7 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar duhet që për të ardhurat globale të tatohet në Republikën e Shqipërisë. Në rast se, për të ardhurat e përfituara jashtë Republikës së Shqipërisë është mbajtur tatimi në vendin e burimit, atëherë individi përfitues bën kreditimin e tatimit në bazë të nenit 37 të ligjit të sipërcituar.

Lidhur me pyetjen për të ardhurat e përfituara në bazë të kontratës së nënshkruar për vitin 2019, duhet që përpara aplikimit për pajisjen me Çertifikatë Rezidence për vitin 2020, të keni paguar tatimin mbi të ardhurat personale.

Pagimin e tatimit individi e bën me DIVA, pavarësisht se të ardhurat vjetore mundet të mos kenë kaluar shumë 2,000,000 lekë në vit. DIVA ka një rubrikë ku shënohen të ardhurat nga jashtë Republikës së Shqipërisë dhe individi deklarues vendos të ardhurat personale të përfituara nga jashtë RSH.

Sipas dispozitave ligjore të ligjit 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, neni 13 deri 13.10, detyrim për të plotësuar dhe dorëzuar DIVA e kanë individët me të ardhura mbi 2,000,000 lekë në vit, por DIVA plotësojnë edhe individët të cilët kanë të ardhura personale që nuk i kanë tatuar gjatë vitit fiskal.

*Përsa i përket pajisjes me Çertifikatë Rezidence për vitin 2020, duhet të plotësohen kushtet:*

- a) interesat jetikë të lidhura ngushtë me RSH
- b) interesat ekonomikë të lidhura ngushtë me RSH
- c) kohëqëndrimi në RSH për një periudhë 183 ditë

d) pagesa e tatimit mbi të ardhurat personale për të ardhurat e përfituara jashtë RSH vitin 2019, pasi individi është pajisur me Çertifikatë Rezidence për këtë vit fiskal.

Faleminderit per mirekuptimin.

Pune te mbare

Hermelinda Hysenaj  
Specialiste e Sektorit te Asistences dhe Sherbimit  
Drejtoria e Sherbimit ndaj Tatimpaguesve

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

Tel Office : 04 2276 840

Web: [www.tatime.gov.al](http://www.tatime.gov.al)